




UDHËZUES

Paraqitja dhe Formatimi i Dizertacionit

Universiteti i Arteve



Përmbatje:

- **Origjinaliteti i punimit**
- **Respektimi i formatit**
- **Doktoraturat ndërinstitutionale**
- **Dorëzimi i kopjeve**
- **Kërkesat e formatit të Dizertacionit**

1. Origjinaliteti i punimit



Tema e dizertacionit duhet të përbëjë një **punim** artistiko-shkencor origjinal.

2. Respektimi i formatit



Dizertacioni duhet të përgatitet në përputhje me udhëzimet zyrtare të paraqitjes.



Punimet që nuk i përmbushin këto kërkesa **nuk pranoen** deri në përmbushjen e të gjitha elementeve të formatit.

3. Doktoraturat ndërinstitutionale



Në programet **ndërinstitutionale** mund të aplikohen standarde të ndryshme të paraqitjes, të cilat duhet të jenë **të përcaktuara në marrëveshjen** mes palëve partnere.

4. Dorëzimi i kopjeve



Kandidati duhet të dorëzojë të paktën **5 (pesë) kopje** origjinale të dizertacionit.

5. Kërkesat e formatit të Dizertacionit



Gjatësia

Kopertina

Faqja e parë

Kërkesa teknike të shtypjes dhe tekstit

Struktura e brendshme dhe numërimet

Shënimet, tabelat, diagramet dhe figurat

Materialet shoqëruese

Bibliografia

Rregullat e citimit dhe përdorimit të burimeve

REPUBLIKA E SHQIPERISE
 UNIVERSITETI I ARTEVE
 FAKULTETI I ARTIT SKENIK

Adresa: Blv. "Dëshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë Shqipëri. Tel: +355 42 247 596, www.uart.edu.al

Programi i studimeve të Doktoratës në Emri Programit

TITULLI I TEMËS

Emri i autorit
Emri i udhëheqësit shkencor

Tiranë, viti

Adresa: Blv. "Dëshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë Shqipëri. Tel: +355 42 247 596, www.uart.edu.al

5.1 Gjatësia



Dizertacioni duhet të ketë rreth **200–250 faqe**, duke përjashtuar figurat, shembujt dramaturgjik/filmikë apo letrar dhe tabelat me numëruesit përkatës.

5.2 Kopertina



Kopertina formatohet sipas **Tabelës 1**, me këtë renditje:

- Në krye, në qendër: **Logo e Universitetit të Arteve.**
- Më poshtë: **Emërtimi i programit të studimit.**
- Në qendër të faqes:
 - o **Titulli i plotë i temës**
 - o **Emri i kandidatit/autorit**
 - o **Emri i udhëheqësit**
 - o **Emri i bashkëudhëheqësit**
 - o **Viti i mbrojtjes**

5.3 Faqja e parë



Duhet të përmbajë:

- **Përmbledhjen (abstraktin)** në gjuhën shqip dhe në anglisht
- Secili abstrakt deri në **200 fjalë**
- Fonti: **Times New Roman 10**

Gjithashtu:

- **Fusha e studimit** dhe **fjalët kyçe** në shqip dhe anglisht

5.4 Kërkesa teknike të shtypjes dhe tekstit



Letra dhe lidhja

- Format i letrës: **A4**
- Letër e bardhë, cilësi e lartë
- Dizertacioni duhet të jetë **i lidhur**



Shtypja

- Shtypet vetëm në **një anë të letrës**
- Dorëshkrimet **nuk pranohen**



Fonti dhe hapësirat

- Teksti: **Times New Roman 12**
- Hapësira mes rrjeshtave: **1.5**
- Tabelat e gjata: **hapësirë 1**
- Shënimet, citimet, bibliografia: **Times New Roman 10**



Margjinat

- Hapësira e sipërme: **1"**
- Hapësira e poshtme: **1"**
- Hapësira e Djathtë: **1.25"**
- Hapësira e majtë: **1.25"**



Numrat e faqeve

- Vendosen **poshtë, në qendër** të faqes.

5.5 Struktura e brendshme dhe numërimet



Parathënia

- Shkruhet me shkronja **kursive**



Numërimi

- Hyrja: **shifra romake**
- Pjesa tjetër e punimit: **numra arabë**
- Bibliografia dhe shtojcat: **numra arabë**

5.6 Shënimet, tabelat, diagramet dhe figurat



Tabelat

- Numërohen me **numra arabë**
- Vendosen **brenda tekstit**, jo në fund të punimit
- Në krye të tabelës:
 - Fjala "**Tabelë**"
 - Numri përkatës
 - Legjenda
- Kur tabela vazhdon në faqen vijuese legjenda **nuk përsëritet**
- Nëse tabela përmban citime, **referencat janë të detyrueshme**.



Shënimet (footnotes)

- Vendosen në **fund të faqes** ku shfaqen.



Diagramet dhe figurat

- Vendosen në faqen përkatëse
- Numërohen me **numra arabë**
- Shpjegimet vendosen **poshtë figurës ose diagramës**.
- Kur një diagramë vijon në faqen tjetër, ndiqet **i njëjti rregull si për tabelat**

5.7 Materialet shoqëruese



Kur dizertacioni ka materiale shtesë (CD, video, etj.):

- Ato **bashkëngjiten** fizikisht me punimin
- Shënohen te **Tryeza e lëndës**
- **Tryeza e lëndës** qëndron në fillim të punimit

5.8 Bibliografia, citimet dhe përdorimi i burimeve



Bibliografia

- Vendoset **në fund të punimit**



Përdorimi i ideve apo punimeve të autorëve të tjerë

- Duhet të **evidentohet** në tekst dhe në listën e referencave/bibliografi



Citimet

- Duhet të **shënohen qartë** me burimin përkatës



Sqarimet e kandidatit

- Vendosen në **klapa katrore**



Burimet dytësore

- Kur burimi origjinal mungon, por është gjetur në një burim të dytë, **duhet të citohen të dy burimet.**



Për më shumë informacion mbi kërkimin shkencor, mund të klikoni

Kërkimi Shkencor në UART



Faleminderit

